

VENDIM
Nr.105, datë 22.2.2006

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.229, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR CEREMONIALIN ZYRTAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 21 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 4 të “Konventës së Vjenës për marrëdhëniet diplomatike”, ratifikuar me dekretin nr.7164, datë 10.10.1987, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, në kapitullin II “CEREMONIALI DIPLOMATIK”, pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Akreditimi i shefit të Misionit Diplomatik të Republikës së Shqipërisë

1/1.1 Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë dhe me “Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike” (neni 4, paragrafi i parë: “shteti dërgues duhet të sigurohet që agreementi i shtetit pritës të jetë dhënë për personin që ai propozon të akreditojë si shef të misionit, pranë këtij shteti), akreditimi i ambasadorëve të Republikës së Shqipërisë, si proces, kalon në disa shkallë, gjatë të cilave kërkohet plotësimi i formaliteteve të paracaktuara.

1/1.2 Ministri i Punëve të Jashtme i paraqet Kryeministrit propozimet për emërimin e ambasadorëve.

1/1.3 Kur Kryeministri miraton kandidatët, Ministri i Punëve të Jashtme kërkon akreditimin e ambasadorit në shtetin pritës apo organizatën ndërkombëtare, ku ai do të akreditohet.

1/1.4 Pasi shteti pritës a organizata ndërkombëtare, ku do të akreditohet ambasadori, vlerëson kandidaturën për ambasador dhe miraton agreementin, Presidenti i Republikës emëron ambasadorin, në përputhje me parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha